



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada -Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas(Gllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr 402/dl-44464 Dt. 09/09/2024

THIRRJE PUBLIKE

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1.Komuna e Drenasit u bënë thirrje të gjitha organizatat joqeveritare (OJQ), të regjistruara dhe programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe personave fizik, të aplikojnë për mbështetjen financiare për zbatimin e projektit që kontribuon në promovimin dhe zhvillim të kulturës, rinisë dhe sportit.

2.OJQ-të dhe personat fizik në përputhje me këtë Thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për aktivitetet e mëposhtme, por duke mos u kufizuar vetëm në këtë:

- Klubet sportive (pagesa e regjistrimit të klubeve në Federatat përkatëse, e kuotizimit, referimit, transportit dhe të ushqimit për ndeshjet zyrtare etj.)
- Sportistët e dalluar
- Garat sportive
- Shoqëritë amatore(ansamblet)
- Teatrot amatore
- Festivalet
- Botimi i librave/shkrimeve letrare
- Ekspozitat me fotografi/pikturë
- Aktivitete me karakter garuese
- Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
- Promovim i librave
- Promovim i talenteve të rinjë

3.OJQ-ja ose individi mund të paraqesë vetëm një projekt në kuader të kulturës,të rinisë apo sportit, i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktivitetit të paraparë me pikën 2 të kësaj Thirrjeje publike.

4. Vlera e përgjithshme e planifikuar e Thirrjes publike është 100,814.25 € (njëqind mijë e tetë qind e katërmbëdhjetë euro e njëzet e pesë cent), nga e cila për:

- Kulturën – 9,000.00 €
- Rininë – 1,000.00 €
- Sportin – 90,814.25 €

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është **250.00 €**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **70,000.00 €**.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimit është 15 ditë pune nga dita e publikimit të Thirrjes Publike,

Përkatësisht dita e fillimit është **09.09.2024**, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është **27.09.2024**.

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Drenasit dhe të cilat veprojnë dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të Thirrjes publike, si dhe personat fizik banorë të Komunës së Drenasit.

OJQ-ja aplikuese duhet të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore, rinore ose sportive, si dhe nëse ka qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Drenasit, të njëjtat mjete i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar dhe narrativ.

Para nënshkrimit të kontaktës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në kuadër të formularit të paraparë, të cilin së bashku me Udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Komunës së Drenasit* - kk.rks-gov.net/drenas.

Dokumentete kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në zarf të mbyllur, në adresën e mëposhtme: Komuna Drenas, rrugë “Xhevë dhe Fehmi Lladrovci” 13000.

Procesi i panimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, resurset, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e aplikacioneve dhe në formë të përcaktuar me Thirrjen Publike.

Lista e dokumenteve të thirrjes publike

- Aplikacioni (Formulari për përshkrimin e projektit/programi në CD);
- Formulari i buxhetit;
- Dokumenti identifikues;
- Certifikata e vendbanimit (për personat fizik e juridik);
- Certifikata e regjistrimit (për personat juridik);
- Certifikatën e numrit fiskal të OJQ-së;
- Dëshmi për pagesën tatimit në pronë (për personat fizik e juridik);

Dokumentacioni obligativ për përfituesit e përzgjedhur të subvencioneve;

- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për personat juridik jo më e vjetër se 3 muaj);
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
- Dëshmi se nuk është nën hetime për vepër penale (jo më e vjetër se 3 muaj)

Vërejtje: Të gjitha aplikimet të cilat nuk kanë dokumentacionin e kompletuar sipas thirrjes nuk do të merren parasysh.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci